

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi - Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa pranohet - Neni 365 LPK/ Neni 67 LMMF/ Neni 354 (2) pika - besimi i fëmijëve-14 LPK/ Nenet 111, 116 dhe 117 LMMF/ Neni 284 (1) LMMF- ushqimi i fëmijëve]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Prizren vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit dhe vendosi për kujdestarinë dhe alimentacionin e fëmijëve të mitur.

Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i Gjykatës së Qarkut përmban shkelle esenciale të nenit 354 paragrafit 2 pikës 14 të LPK-së. Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i Gjykatës së Qarkut nuk përmban arsyetim për faktet vendimtare të cilat ishin të rëndësishme për shqyrtimin e duhur të kësaj çështje ligjore dhe se nuk ka qenë në gjendje të vërtetojë gjendjen faktike plotësisht. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e të paditurit është e bazuar.

Ac.nr.1/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Shahdane Agani dhe Osman Tmava , anëtarë, në çështjen juridike të paditëses L. T. nga fshati Demjan të cilën e përfaqëson Adem Jetishi avokat nga Prizreni , kundër të paditurit Q. T. nga fshati Karashingjergj të cilin e përfaqëson Myrvete Qollaku avokate nga Prizreni , për zgjidhjen e martesës përkitazi me ankesën e të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren C.nr.265/2004 datë 14.12.2004 në seancën e mbajtur më 14.3.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet ankesa e të paditurit dhe prishet në pjesët II , IV dhe VI të dispozitivit aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren C.nr.265/2004 datë 14.12.2004, kurse lënda i kthehet së njejtës Gjykatë për rigjykim.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë në pjesët I, III dhe V mbeten të pasqyrtuara.

A r s y e t i m i

Me pjesën I. të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren C.nr.265/2004 datë 14.12.2004, është zgjidhur martesë mes paditëses dhe të paditurit e lidhur me 16.6.1992 në Zyrën e vendit në fshatin Zym Komuna e Prizrenit. Me pjesën II. të dispozitivit, fëmijët e mitur G. e lindur më 17.8.1995 dhe H. i lindur më 10.7.1997 iu kanë besuar për ruajtje dhe edukim paditëses ëmës L., ndërsa fëmiju i mitur G. i lindur më 28.10.1992 i është besuar në ruajtje dhe edukim të paditurit babasë. Me pjesën III. të dispozitivit, kontaktimi i të paditurit me fëmijtë e mitur është caktuar vikendin e parë të muajit si dhe gjatë pushimeve verore në fillim dhe atë gjatë pushimeve dimërore 5 ditë, ndërsa gjatë pushimeve verore 15 ditë t'i kalojnë me të atin. Kontaktimi paditëses me fëmijun e mitur G. është caktuar në vikendin e tretë si dhe në fund të pushimeve dimërore 5 ditë dhe pushimeve verore 15 ditë.

Me pjesën IV të dispozitivit është detyruar i padituri që në emër të ushqimit për fëmijët e mitur G. dhe H. t'ia paguajë nga 60 €, gjithsej 120 €, në muaj duke filluar prej 14.12.2004 gjersa ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë paditëses gjerë më datën 5 të muajit . Me pjesën V. të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses që të detyrohet i padituri që asaj t'ia paguajë në emër të ushqimit shumën prej 200 €, në muaj si dhe për fëmijtë e mitur mbi shumat prej 60 € në muaj. Me pjesën VI. të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që aktgjykimi i shkallës së parë, në pjesën II dhe IV të dispozitivit, të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Paditësja ka paraqitur përgjegje në ankesë me propozimin që ankesa e të paditurit të refuzohet si e pabazuar.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se ndërgjyqësit kanë lidhur bashkësinë martesore me 16.6.1992 në fshatin Zym. Në këtë bashkësi u kanë lindur 3 fëmijë G. më 28.10.1992, G. më 17.8.1995 dhe H. më 10.7.1997. Në fillim të martesës marrdhënie martesore kanë qenë të mira, por më vonë ato janë keqësuar gjerë në atë masë sa që jeta bashkëshortore është bërë e padurueshme. Për shkak të çrregullimeve serioze dhe të vazhdueshme të marrdhënieve bashkëshortore , bashkësia mes tyre definitivisht ka pushuar në muajin mars të vitit 2004.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 67 i LMMF, që të zgjidhet martesë e ndërgjyqësve, për

arsye se më 02.3.2004 bashkësia mes tyre definitivisht ka pushuar dhe ajo nuk është rivendosur dhe se ky çrregullim i marrdhënieve bashkëshortore është i vazhdueshëm. I padituri me ankesë nuk e ka goditur aktgjykimin në pjesë që ka të bëjë për zgjidhjen e martesës. Gjykata e Shkallës së Parë fëmit e mitur G. dhe H. i ka besuar paditëses, ndërsa fëmiun e mitur G. ia ka besuar të paditurit, me arsyetimin se fëmit e mitur momentalisht gjinden tek paditësja dhe emocionalisht më shumë janë lidhur me nënën-paditësen, si dhe faktin që është në interesin e fëmijëve të mitur H. dhe G. që tani për tani të jenë nën kujdesin e të ëmës, ndërsa për fëmiun e mitur G. ka pasur parasysh që i njejtë është nën kujdesin e të atit nga fillimi si dhe dëshirën e tij që të besohet babait të tij. Kontaktimi i fëmijëve me prindërit është caktuar si në pjesën III të dispozitivit të aktgjykimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimi i goditur në pjesën II dhe IV të dispozitivit është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 354 par.2 pika 14 të LPK. Përveqë kësaj gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë.

Aktgjykimi i goditur nuk përman arsyetimet për faktet vendimtare, të rëndësishme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike dhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë. Nga mendimi i Qendrës për Punë Sociale në Prizren del përshkrimi i kushteve materiale të paditurit dhe prej plotësimit të mendimit të datës 26.10.2004, del se ekipi i shërbimit social është i mendimit që fëmijët e mitur t'i besohen për ruajtje dhe edukim të paditurit të atit. Nga mendimi i Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë del se ekipi i shërbimit është i mendimit që fëmit e mitur t'i besohen për ruajtje dhe edukim paditëses nënës L., sepse fëmijët janë në moshën në të cilën kujdesi i nënës është i domosdoshëm nga aspekti emocional si dhe fakti që ato gjinden tek paditësja, pas një kohe të shkurtër nga momenti kur bashkësia martesore faktikisht është ndërprerë mes ndërgjyqësve. Mendimi i Qendrës për Punë Sociale Gjakovë nuk përman përshkrimin e kushteve materiale dhe banesore e paditëses.

Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka dhënë arsye lidhur me lidhjen emocionale të fëmijëve të mitur me njerin apo tjetrin prind si dhe ndikimin e drejtë përdrejtë të prindërve në edukimin e tyre. Përveqë kësaj në rastin konkret në shkresat e lëndës gjenden dy raporte të kundërta me dy propozimet për besimin e fëmijëve të mitur.

Me dispozitën e nenit 116 të LMMF është parashikuar që Gjykata, përkatësisht organi i kujdestarisë i cili e merr vendimin mbi besimin e fëmijëve për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme t'i hetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijëve dhe, me rastin e marrjes të vendimit të nisët, në rradhë të parë, nga interesat e fëmijëve. Me atë rast posaqërisht i merr parasysh nevojat

emocionale dhe dëshirat e fëmijëve nëse ka mbushur 10 vjet, për të cilën gjë merr vendimin nga ekspertët përkatës, gjithmonë kur këtë gjë e kërkojnë rrethanat erastit.

Gjykata e Shkallës së Parë është e detyruar që në riprocedurë t'i menjanojë të metat e cekura duke i pasur parasysh edhe thëniet ankimore e të paditurit, të kërkojë prej të dy qendrave për punë sociale (në Prizren dhe në Gjakovë), t'i harmonizojnë mendimet konkluzionet lidhur me besimin e fëmijëve të mitur me përshkrimin e kushteve materiale dhe banesore të paditëses, duke pasur parasysh moshën e fëmijëve dhe lidhjen emocionale të tyre me prindërit dhe ndarjen e fëmijëve lidhur me besimin e tyre njerit apo tjetrit prind, të marrë mendimin nga eksperti-psikologu lidhur me faktin se qfar ndikim mund të ketë ndërimi i mjedisit jetësor në psikikën e fëmijëve të mitur si dhe reagimin e tyre në mjedisin ku jeton paditësja. Me këtë rast posaqërisht merren parasysh nevojat emocionale të fëmijëve ndaj prindërve, gjë që do të thotë se interesat e prindërve vijnë në rend të dytë.

Nga se faktet e cekura janë fakte relevante për marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm, mungesa e arsyetimit paraqet shkak për prishjen e tij.

Gjykata e Shkallës së Parë është e detyruar që në rigjykim të vendosë sipas neneve 111, 116 dhe 117 të LMMF dhe, pas vërtetimit të të gjitha rrethanave të rëndësishme, të marrë një vendim të ligjshëm.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është prishur edhe në pjesën IV të dispozitivit që ka të bëjë për ushqim e të miturve, cila pjesë është goditur me ankesë, ashtu që Gjykata e Shkallës së Parë pas vërtetimit të fakteve të sipër përmendura lidhur me besimin e fëmijëve për ruajtje dhe edukim duhet të marrë vendim lidhur me nenin 284 par.1 të LMMF me të cilin parashikohet që prindërit kanë për detyrë që t'i ushqejnë fëmijët e tyre të mitur.

Meqë aktgjykimi u prish në pjesën II dhe IV është prishur edhe vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë në pjesët I, III dhe V të dispozitivit mbetën të pasqyrtuara, pasi që në këto pjesë ato nuk janë goditur me ankesë.

Në bazë të asaj që u tha me zbatimin e nenit 369 dhe 370 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1/2005, datë 14.3.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës- ankesa refuzohet - Neni 365 LPK/ Neni 67 LMMF]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesat e parashikuara me nenin 67 të LMMF janë plotësuar për prishjen e martesës ndërmjet ndërgjyqësve. Gjykata Supreme ka vendosur se martesë duhet të mbahet vetëm nëse ekziston dashuri e ndërsjellë ndërmjet bashkëshortëve e cila shfaqet nëpërmjet të bashkëjetesës së harmonishme dhe vullneti i vetëm njërit prej bashkëshortëve për të mbajtur martesën nuk mjafton. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e palës së paditur është e pabazuar.

Ac.nr.4/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Shahdane Agani dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses M. J.-D. nga Novesella, me vendqëdrim në Zvicër, të cilën e përfaqëson i autorizuari A. J. ndërsa këtë e përfaqëson R. Gj. avokat nga Gjakova, kundër të paditurit B. D. nga Prishtina të cilin e përfaqëson i autorizuari i ati D. D. nga Prishtina për zgjidhjen e martesës përkitazi me ankesën e të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë C.nr.321/2004 datë 26.11.2004, në seancën e mbajtur më 14.3.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë C.nr.321/2004 datë 26.11.2004.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë C.nr.321/2004 datë

26.11.2004, është zgjidhur martesë mes paditëses dhe të paditurit, e lidhur më 31.7.2003 në zyrën e ofiqarisë në Klinë me nr.57/34-MR. është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri me kohë ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, Gjykata Supreme ka gjetur se ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë me 31.7.2003. Ndërgjyqësit sipas traditave janë fejuar me 31.7.2002. Pas kësaj kohe kanë lidhur martesë më 31.7.2003, por bashkëshortët realisht janë bashkuar më 26.4.2004, për arsye se paditësja gjendet në Zvicër dhe i padituri pas rregullimit të dokumentacionit në prill të vitit 2004 ka shkuar në Zvicër. Menjëherë pas bashkimit të bashkëshortëve marrdhëniet mes tyre janë çrregulluar, ashtu që bashkësia martesore faktikisht është ndërprerë më 20.6.2004, ashtu që paditësja ka vazhduar qëndrimin në Zvicër, ndërsa i padituri është kthyer në vendlindje.

Për shkak se raportet mes ndërgjyqësve janë çrregulluar në mënyrë serioze e duke pasur parasysh faktin se bashkëshortët prej vitit 2004 nuk jetojnë bashkë, respektivisht në bashësi martesore kanë jetuar vetëm dy muaj, Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet e parashikuara me nenin 67 të LMMF, që të zgjidhet martesë e ndërgjyqësve.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykata e Shkallës së Parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, në bazë të së cilës e ka zbatuar drejtë edhe të drejtën materiale, duke zgjidhur martesën e ndërgjyqësve, për çka në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Martesë duhet të mbahet vetëm kur ekziston dashuria e ndërsjellë e bashkëshortëve, e cila shfaqet edhe me një bashkëjetesë të harmonishme të tyre dhe nuk mjafton për ruajtjen e saj vetëm dëshira e njërit bashkëshort, sikurse pa bazë thuhet në ankesë, sipas së cilës është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Aktgjykimi i goditur nuk përmbanë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të parashikuara nga neni 354 par.2 të LPK, të cilat kjo Gjykatë i vërenë edhe sipas detyrës zyrtare.

Thëniet në ankesë e të paditurit se anëtarë të trupit gjykues nuk kanë qenë të pranishëm, janë të pabazuara, për arsye se nga procesverbali mbi shqyrtimin kryesor të datës 26.11.2004, del se emrat e gjyqëtarëve porot janë

shënuar në procesverbalin mbi shqyrtimin kryesor, ndërsa i padituri nuk ka bërë vërejtje për mospranimin e anëtarit të trupit gjykues. Ky fakt vërtetohet edhe nga procesverbali mbi votimin që gjinden në shkresat e lëndës. Thëniet e tjera të ankesës të të paditurit janë përsëritje e thënieve të cekura në seancat e mbajtura pranë Gjykatës së Shkallës së Parë si dhe me parashtrësat me shkrim, të cilat kanë qenë objekt shqyrtimi gjatë marrjes së vendimit nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Në bazë të asaj që u tha me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4/2005, datë 14.3.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa refuzohet Neni - 365 LPK/ Neni 67 LMMF/ Neni 223 LPK- zbatimi i vlerësimit të lirë- ushqimi]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit dhe urdhëroi paditësin të paguajë alimentacionin për të paditurin.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesat e parashikuara me nenin 67 të LMMF janë plotësuar për prishjen e martesës ndërmjet ndërgjyqësve. Gjykata Supreme ka vendosur se marrëdhëniet martesore ndërmjet ndërgjyqësve ishin çrregulluar në mënyrë serioze dhe vazhduese dhe nuk ka gjasë që të rregullohen. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e palës së paditur është e pabazuar.

Ac.nr.5/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr. Rifat Zylfiu dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Q. F., nga fshati Ratishë e Epërme, komuna e Deçanit, të cilën e përfaqëson Pashë Kuqi, avokat nga Deçani, kundër të paditurës Xh. F., nga fshati Ratishë e Epërme, komuna e Deçanit, të cilën e përfaqëson Nexhdet Gora, avokat nga Peja, për zgjidhjen e martesës, përkritazi me ankesën e së paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 347/2004 datë 8.11.2004, në seancën e mbajtur më 17.03.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e së paditurës dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 347/2004 datë 8.11.2004.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 347/2004 datë 8.11.2004, është zgjidhur martesë e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës. Me pjesën II të dispozitivit paditësi është detyruar që në emër të ushqimit të paguajë për të paditurën nga 100 € në muaj, duke filluar prej 8.11.2004, gjer sa të ekzistojnë kushtet për këtë pagesë, në afatin prej 15 ditësh, pas marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm. Me pjesën III të dispozitivit është refuzuar kërkesëpatria e paditëses që paditësi t'i paguajë asaj në emër të ushqimit 200 € në muaj, duke filluar prej 8.11.2004 e gjersa të ekzistojnë kushtet ligjore dhe me pjesën IV të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura me kohë ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi të prishet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se ankesa është e pabazuar.

Nga aktgjykimi i goditur dhe shkresat e lëndës del se ndërgjyqësit kanë lidhur bashkësi martesore më 24 janar 1973 në Zyrën e vendit Isniq. Në këtë bashkësi u kanë lindur gjashtë fëmijë, të cilët janë të moshës madhore. Në fillim të martesës marrëdhëniet martesore kanë qenë të mira, por prej vitit 1991 jetojnë të ndarë: e paditura me fëmijët jeton në shtëpinë e tyre në fshatin Ratishë, ndërsa paditësi jeton dhe punon në Gjermani dhe ka lidhur bashkësi jashtëmartesore me një grua tjetër, me të cilën ka dy fëmijë. Për shkak të çrregullimit të këtyre marrëdhënieve bashkëshortore, bashkësia martesore mes tyre ka pushuar.

Për shkak se marrëdhëniet martesore janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe nuk ka gjasa për rivendosjen e bashkëjetesës mes tyre, Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet e parashikuara me nenin 67 të Ligjit për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (LMMF), që të zgjidhet martesë e ndërgjyqësve.

Sipas mendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, marrëdhëniet bashkëshortore mes ndërgjyqësve janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme, prandaj nuk ka gjasa për rivendosjen e tyre, veçanërisht duke pasur parasysh se ata jetojnë ndaras dhe faktin se paditësi jeton në bashkësi jashtëmartesore me një femër tjetër, me të cilën ka dy fëmijë. Duke i pranuar si të drejta arsyet e aktgjykimit të shkallës së parë, kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Shkallës së Parë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale - neni 67 të LMMF, kur e ka zgjidhur martesën e ndërgjyqësve, duke gjetur se ajo ka humbur qëllimin e ekzistimit. Martesa duhet të mbahet vetëm kur ekziston dashuria e ndërsjellë e bashkëshortëve, e cila shfaqet edhe me një bashkëjetesë të harmonishme të tyre dhe nuk mjafton për ruajtjen e saj dëshira e njërit bashkëshort.

Gjykata e Shkallës së Parë e ka detyruar paditësin që për të paditurën ta paguajë, në emër të ushqimit, nga 100 € në muaj. Në këtë rast kemi të bëjmë me zbatimin e vlerësimit të lirë - nenit 223 i LPK, sipas të cilit, kur gjykata vërteton se palës i takon një shumë të hollash, por lartësia e shumës nuk mund të vërtetohet ose do të mund të vërtetohet me shpenzime joproporcionale, ajo do të vendosë sipas vlerësimit të lirë. Prandaj, duke marrë parasysh se detyrimi i paditësit përmbushet me pagesën e shumës prej 100 € në muaj, Gjykata Supreme konsideron se nuk është bërë shkelja e së drejtës materiale në dëm të së paditurës.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Ac.nr.5/2005, datë 17.03.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa pranohet - Neni 365 LPK/ Neni 354 (2) pika 8 LPK/ Nenet 369 LPK]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Prizren vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit. Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i Gjykatës së Qarkut përmban shkelje esenciale të procedurës kontestimore siç parashikohet me nenin 354 paragrafin 2 pikën 8 të LPK-së. Pala e paditur në mënyrë të paligjshme nuk i është dhënë e drejta për rishikim gjyqësor pranë kësaj Gjykate për shkak se saanca është mbajtur në mungesë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e palës së paditur është e pabazuar.

Ac.nr.9/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr. Rifat Zylfiju dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit N. Q., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson Muharem Skenderi, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës S. Q., nga Beogradi, për zhgjidhjen e martesës, përkitazi me ankesën e së paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, C.nr. 233/2003 datë 19.03.2004, në seancën e mbajtur më 17.03.2005, mori këtë

A K T V E N D I M

Pranohet ankesa e së paditurës dhe prishet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren, C.nr. 233/2003 datë 19.03.2004, kurse lënda i kthehet së njëjtës Gjykatë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Prizren, C.nr. 233/2003 datë 19.03.2004, është zgjidhur martesja e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës më 24.09.1972 në Beograd. Është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura me kohë ka paraqitur ankesë, për

shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se Gjykata e Shkallës së Parë, në seancën për shqyrtimin kryesor të datës 19.03.2004, ka konstatuar se e paditura nuk ka ardhur në seancën për shqyrtimin kryesor, edhe pse është thirrur me rregull, prandaj ka marrë vendim që seanca të mbahet në mungesë të së paditurës.

Nga shkresat e lëndës del se seanca për shqyrtimin kryesor është caktuar për 19.03.2004, kurse e paditura, edhe pse ka qenë e thirrur me rregull, nuk ka ardhur në seancën për shqyrtimin kryesor, për arsye se ka qenë e penguar, sepse më datë 17 dhe 18 mars 2004, ka pasur trazira në Kosovë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimi i goditur përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuar nga neni 354 par. 2 pika 8 e LPK, të cilën kjo Gjykatë e vëren sipas detyrës zyrtare. Kjo ngase, me veprim të paligjshëm, palës së paditur nuk i është dhënë mundësia të zhvillojë shqyrtim para Gjykatës, sepse seanca është mbajtur në mungesë të saj, edhe pse është ditur botërisht se, për arsye të trazirave në Kosovë, lëvizjet kanë qenë të kufizuara më 17 dhe 18 mars 2004, prandaj e paditura nuk ka mundur të vinte me kohë nga Beogradi për të marrë pjesë në seancën për shqyrtimin kryesor të caktuar për datën 19.03.2004, në orën 11,00.

Gjykata e Shkallës së Parë është e detyruar që në riprocedurë t'i mënjanojë të metat e cekura, duke i pasur parasysh edhe thëniet ankimore dhe të vendosë sipas ligjit.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 369 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Ac.nr. 9/2005, datë 17.03.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore kompensim i shpenzimeve të ushqimit ankesa refuzohet - Neni 365 LPK/ Neni 297 LMMF/ Neni 305 (1) LMMF]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Pejë ka refuzuar kërkesëpadinë e palës së paditur të paraqitur për urdhërimin e paditësit që të paguajë alimentacionin për fëmijën e mitur.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur ka vendosur se kërkesat e parashikuara me nenin 297 të LMMF nuk janë plotësuar, e cila parashikon se në rast të kontestit të alimentacionit ndërmjet prindërve gjykata merr parasysh kontributin e prindit të cilit i është besuar fëmiju për kujdes dhe edukim i cili ofron kujdes dhe mirëqenie për fëmijun. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.

Ac.nr.10/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Mr.Rifat Zylfiu dhe Shahdane Agani, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses - të kundërpaditurës A. B., nga Shkodra, të cilën e përfaqëson Ferid Xhikolli, avokat nga Peja, kundër të paditurit-kundërpaditësit A. B., nga Gjakova, të cilin e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, përkitazi me ankesën e kundërpaditësit, paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr.169/2002 datë 01.12.2004, në seancën e mbajtur më 28.04.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit-kundërpaditësit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr.169/2002 datë 01.12.2004.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr.169/2002 datë 01.12.2004, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e të paditurit-kundërpaditësit që të detyrohet paditësja-e kundërpaditura që, në emër të ushqimit për të miturin A., t'i paguajë shumën prej 100 €. në muaj, duke filluar prej 1.12.2000 e në të ardhmen, gjersa të ketë kushte ligjore për pagesën, më së voni prej 1-5 të muajit, ndërsa këstet e arritura e të papaguara dhe kamatën përkatëse ligjore t'i paguajë nga data e arritjes së secilit këst veç e veç si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha në afat prej 15 ditësh.

Kundër këtij aktgjykimi kundërpaditësi ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i goditur të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjyqimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Pejë C.nr.69/2001 datë 12.12.2001, është zgjidhur martesja e palëve ndërgjyqëse, kurse i mituri Andi, i lindur më 4.1.1996, i është besuar për ruajtje dhe edukim paditëses-nënës. Me aktgjykimin e kësaj Gjykate, Ac.nr.1/2001 datë 14.05.2002, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, por i njëjti aktgjykim, në pjesën në të cilën është refuzuar kërkesa që të detyrohet paditësja të paguajë për të miturin ushqimin, është prishur dhe lënda, në pjesën IV të dispozitivit, është kthyer për rigjykim.

Gjykata e Shkallës së Parë në riprocedurë, pas administrimit të provave të nevojshme, ka gjetur se kërkesa e të paditurit-kundërpaditësit është e pabazuar, për arsye se i mituri Andi i është besuar paditëses- të kundërpaditurës për ruajtje dhe edukim me aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë nga data 12.12.2001, ashtu që i padituri nuk ka vepruar sipas aktgjyqimit të Gjykatës, respektivisht përmbarrimin lidhur me dorëzimin e të miturit e ka bërë të pamundshëm.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, në bazë të së cilës e ka zbatuar drejt edhe të drejtën materiale. Me nenin 297 të LMMF është parashikuar që në kontestin e prindërve për ushqimin e fëmijës, prindit që i është besuar fëmija për ruajtje dhe edukim, Gjykata, si kontribut të tij për ushqimin e fëmijës, posaçërisht e merr punën dhe përkujdesjen e atij prindi i cili për çdo ditë i kushton kujdesin për mirëritjen e fëmijës. Në rastin konkret, nuk janë plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 297 të LMMF për detyrimin e së kundërpaditurës për pagesën e ushqimit për të miturin A., për arsye se me aktgjykimin e datës 12.12.2001, i cili ka marrë formë të prerë, i mituri A. i është

besuar paditëses-të kundërpaditurës për ruajtje dhe edukim, prandaj edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, kërkesa e kundërpaditësit për pagesën e ushqimit nuk ka bazë juridike në dispozitat e LMMF.

Në arsyetimin e aktgjykimit thuhet se kërkesa e kundërpaditësit është e pabazuar sipas dispozitës së nenit 305 par.1 të LMMF, por kjo Gjykatë vlerëson se neni 305 par.1 i Ligjit të sipërpërmendur ka të bëjë me personin e tretë, i cili ka hequr shpenzimet e ushqimit të ndonjë personi, ashtu që me padi mund të kërkojë kompensimin e atyre shpenzimeve nga ai person që, sipas këtij ligji, ka për detyrë të japë ushqimin, ndërsa në rastin konkret kërkohet ushqimi nga prindi tjetër, të cilit i është besuar fëmija për ruajtje dhe edukim.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren edhe sipas detyrës zyrtare. Gjykata e Shkallës së Dytë e shqyrton aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve të arsyeve të paraqitura në ankesë, me të cilën në këtë rast nuk vihen në dyshim gjendja faktike e vërtetuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Nga sa u parashtrua dhe me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Ac.nr.10/2005, datë 28.04.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa refuzohet - kontakti personal me fëmijët e mitur - Neni 365 LPK/ Neni 67 LMMF/ Neni 117 LMMF]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit dhe vendosi për kontaktin personal me fëmijun e mitur.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur ka vendosur se kërkesat e parashikuara me nenin 117 të LMMF nuk janë plotësuar i cili parashikon që mbajtja e kontakteve personale të fëmijëve me prindërit e tyre mund të kufizohet apo ndalohet përkohësisht për qëllime të mbrojtjes së shëndetit dhe interesave tjerë të famiut. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e palës së paditur është e pabazuar.

Ac.nr.11/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Shahdane Agani dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, në çështjen juridike të paditëses M. D. e lindur Kastrati nga Gjakova të cilën e përfaqëson Rexhep Gjokolli avokat nga Gjakova, kundër të paditurit R. D. nga Gjakova, të cilin e përfaqëson babai A. D. nga Gjakova, për zgjidhjen e martesës, përkritazi me ankesën e të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr.435/2004 datë 04.2.2005, në seancën e mbajtur më 30.3.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë C.nr.435/2004 datë 04.2.2005 në pjesën III të dispozitivit që ka të bëjë me kontaktin personal të paditëses me fëmijët e mitur.

I njejtë aktgjykim në pjesën I dhe II të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë C.nr.435/2004 datë 04.2.2005, është zgjidhur martesë e lidhur më 11.2.1999 mes paditëses dhe të paditurit në zyrën e ofiqarisë në Gjakovë. Me pjesën II të dispozitivit, fëmijët e mitur R. i lindur më 11.3.2000 dhe R. e lindur më 16.10.2003, janë besuar në ruajtje dhe edukim të paditurit babait. Me pjesën III të dispozitivit është vendosur që kontakti personal i të miturve me nënë-paditësen të bëhet dy herë në muaj, në vikendin e parë dhe të tretë të muajit, duke filluar prej orës 12 të së shtunës deri në orën 12 të së dieles. Është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri me kohë ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në pjesën III të dispozitivit, me propozimin që aktgjykimi në këtë pjesë të ndryshohet ose ai të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit në pjesën të goditur sipas nenit 365 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur që ankesa është e pabazuar.

Për shkak se marrdhëniet martesore janë çrregulluar në mënyrë serioze, Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 67 të LMMF që të zgjidhet martesë ndërgjyqësve. Fëmijët e mitur janë besuar në ruajtje dhe edukim të paditurit babait.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të pa baza janë thëniet në ankesën e të paditurit se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas nenit 117 të LMMF, është parashikuar që nëse fëmia jeton në bashkësi me prindërit ose me njërin prej tyre, prindërit do të merren vesh për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën. Në rast të kontestit vendimin lidhur me këtë gjë e merr organi i kujdestarisë. Organi i kujdestarisë përsëri mund të rregullojë mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të prindërve me fëmijën, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Mbajtja e kontakteve personale të fëmijëve me prindërit mund të kufizohet ose të ndalohej përkohësisht vetëm për arsye të mbrojtjes së shëndetit dhe të interesave të tjera të rëndësishme të fëmijëve.

Thëniet ankimore që kanë të bëjnë me faktin se paditësja nuk është e denjë për ushtrimin e të drejtës prindore janë të pabazuara, nga se me asnjë provë nuk është sjellë në dyshim aftësia e saj për ushtrimin e kësaj të drejte. Përveqë kësaj, ankesa me kurfarë propozimesh nuk vënë në dyshim që paditësja gjatë kontaktit me fëmijët e mitur mund të ndikojë negativisht në

edukimin e fëmijëve të mitur, prandaj duke pasur parasysh nenin 117 të LMMF, ankesa e të paditurit është refuzuar si e pabazuar.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë mbetet i pashqyrtuar në pjesën I dhe II të dispozitivit pasi që këto pjesë nuk janë goditur me ankesë.

Në bazë të asaj që u tha me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.11/2005, datë 30.3.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa pranohet pjesërisht - Neni 365 LPK/ Neni 67 LMMF/ Neni 354(2) LPK- besimi i fëmijëve të mitur - Neni 116 LMMF/ Neni 109 LMMF - kontakti personal me fëmijët e mitur - Nenet 111 dhe 117 LMMF/ Neni 369 dhe 370 LPK]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Prizren vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit dhe vendosi që fëmiu i mitur të besohet për kujdes dhe edukim paditësit.

Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i ankimuar në pjesën për besimin e fëmiut për kujdes dhe edukim paditësit si baba dhe pagesën e alimentacionit përmban shkelje esenciale të nenit 354 paragrafit 2 pikës 14 të LPK-së dhe neneve 111, 116 dhe 117 të LMMF.. Gjykata Supreme ka vendosur se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe se aktvendimi nuk përmban arsye të mjaftueshme përkitazi me faktet vendimtare për marrjen e një vendimi të drejtë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e palës së paditur është e pabazë.

Ac.nr.12/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, në çështjen juridike të paditësit Xh. M., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson mr. Vehap Hashani, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës V. M., nga Prizreni, të cilën e përfaqëson Fatmir Celina, avokat nga Prizreni, për zgjidhjen e martesës, përkitazi me ankesën e së paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, C.nr. 142/2004 datë 27.01.2005, në seancën e mbajtur më 30.03.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e së paditurës dhe vërtetohet në pjesën I të dispozitivit, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr. 142/2004 datë 27.01.2005.

Pranohet aneksa e së paditurës dhe prishet në pjesën II, III, IV dhe V të dispozitivit aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren, C.nr. 142/2004 datë 27.01.2005, kurse lënda i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, C.nr. 142/2004 datë 27.01.2005, është zgjidhur martesë ndërmjet paditësit dhe së paditurës, e lidhur më 13.05.1994, pranë shërbimit të ofiqarisë në Prizren. Në pjesën II të dispozitivit fëmijët e mitur: T. i lindur më 24.07.1994, F. i lindur më 6.05.1996, A. e lindur më 13.10.1997 dhe H. e lindur më 25.01.2001, janë besuar për ruajtje dhe edukim paditësit - babas. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar paditësi që t'i mundësojë të paditurës të ketë kontakte me fëmijët e tyre të mitur dy herë në muaj - të shtunden e parë dhe të tretë të muajit, prej orës 10,00 gjer në ora 17,00 dhe t'i mundësojë të paditurës që me fëmijët e tyre të mitur të kalojë gjatë festave fetare nga një ditë, gjatë pushimeve dimërore 5 ditë ndërsa pushimeve verore 15 ditë. Me pjesën IV të dispozitivit, është refuzuar kërkesa e së paditurës që paditësi të detyrohet asaj t'ia paguajë ushqimin si kërkesë pa bazë. Me pjesën V të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura me kohë ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi në pjesën II të dispozitivit të ndryshohet ashtu që fëmijët e mitur t'i besohen asaj në ruajtje dhe edukim dhe paditësi të detyrohet të paguajë ushqimin për fëmijët e mitur dhe për të paditurën.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se ankesa në pjesën II të dispozitivit, të aktgjykimit të goditur është e bazuar.

Nga shkrest e lëndës del se ndërgjyqshit kanë lidhur bashkësinë martesore më 13 maj 1994 në Prizren. Në këtë bashkësi martesore u kanë lindur katër fëmijë. Në fillim ta martesës marrëdhëniet martesore kanë qenë të mira, por më vonë ato janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe prej vitit 2003 jetojnë të ndarë: e paditura jeton me prindërit e saj, ndërsa paditësi jeton me fëmijët e tyre dhe ka lidhur bashkësi jashtëmartesore me një grua tjetër dhe kanë një fëmijë. Për shkak të çrregullimit të këtyre marrëdhënieve bashkëshortore, bashkësia martesore mes tyre ka pushuar.

Për shkak se marrëdhënieit martesore janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme, Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 67 të Ligjit për Martesën dhe

Marrëdhëniet Familjare (LMMF), që të zgjidhet martesë e ndërgjyqësve.

Sipas mendimit edhe të Gjykatës Supreme të Kosovës, marrëdhëniet bashkëshortore mes ndërgjyqësve janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme, prandaj nuk ka gjasa për rivendosjen e tyre, veçanërisht duke pasur parasysh se paditësi jeton në bashkësi jashtëmartesore me I. P. me të cilën ka një fëmijë. Duke i pranuar si të drejta arsyet e aktgjykimit të shkallës së parë, kjo Gjykatë vlerëson se janë të pabazuara edhe thëniet e ankesës se Gjykata e Shkallës së Parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuar nga neni 354 par. 2 të LPK, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimi i goditur që ka të bëjë me vendimin për besimin e fëmijëve të mitur për ruajtje dhe dukim paditësit, si babë, është marrë me shkelje thelbësore të procedurës kontestimore të parashikuar nga neni 354 par. 2 pika 14 të Lijgjit të Procedurës Kontestimore (LPK). Përveq kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë.

Aktgjykimi i goditur në këtë pjesë nuk përmban arsye lidhur me faktet vendimtare për marrjen e një vendimi të ligjshëm. Vendimi për besimin e fëmijëve të mitur nuk përmban arsyetim dhe nuk është cekur se çka përmban mendimi i Qendrës për Punë Sociale, në të cilën mbështetet vendimi për besimin e fëmijëve të mitur për ruajtje dhe edukim. Sipas nenit 116 të LMMF, gjykata e cila merr vendim për besimin e fëmijëve për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme të vërtetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejt psikik e fizik dhe për edukimin e fëmijës dhe, me rastin e marrjes së vendimit, të niset, në radhë të parë, nga interesi i fëmijës. Me atë rast, posaçërisht merr parasysh lidhjet emocionale të fëmijës me prindërit. Gjykata e Shkallës së Parë duhet të veprojë sipas neni 109 të LMMF i cili nen parashikon se të drejtën prindërore e ushtrojnë prindërit bashkarisht dhe me marrëveshje, në rast të mospajtitimit të tyre vendos organi i kujdestarisë. Nga një gjendje e tillë e çështjes del se për faktet e përmendura aktgjykimi i goditur nuk përmban arsye.

Aktgjykimi i goditur në pjesën refuzuese të kërkesës të paditurës për detyrimin ushqimor, nuk përmban arsye dhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë. Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë duhet të vërtetojë se a është paditësja e lajmëruar në Entin e Punësimit dhe a ka gjasa për punësim, pastaj si është gjendja materiale e saj, si siguron mjetet për ekzistencë dhe të vërtetojë gjendjen shëndetësore, përkatësisht aftësinë e të paditurës për punë. Përveq kësaj, duhet të vërtetohet drejt nëse papunësia e saj ka ardhur pa fajin e të paditurës.

Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë duhet të kërkojë mendimin e rij nga Qendra për Punë Sociale në Prizren, që duhet ta përmbajë propozim konkret se cilit prindër duhet t'i besohen fëmijët e mitur, duke marrë parasysh nenin 116 të LMMF, me të cilën parashikohet që gjykata, përkatësisht organi i kujdestarisë, i cili e merr vendimin mbi besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme t'i hetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës dhe me rastin e marrjes së vendimit, të niset në radhë të parë nga interesi i fëmijës. Me atë rast posaçërisht i merr parasysh nevojat emocionale të fëmijës, ta respektojë dëshirën e fëmijës - T., pasi që i mituri ka mbushur 10 vjet.

Gjykata e Shkallës së Parë është e detyruar që në rigjykim t'i menjanojë të metat e cekura gjegjësisht të veprojë sipas neneve 111, 116 si dhe sipas neni 117 të LMMF lidhur me mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të prindërve me fëmijët e mitur, dhe pas vërtetimit të gjitha rrethanave të rëndësishme, të marrë një vendim të ligjshëm.

Duke qenë se aktgjykimi është prishur në pjesën II, III, IV u prish edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 369 dhe nenit 370 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.12/2005, datë 30.03.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa pranohet pjesërisht - Neni 67 LMMF/ Neni 354(2) LPK - kontaktet personale me fëmijën e mitur - Neni 116 LMMF/ Nenet 111 (3) LMMF]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike në lidhje me pjesën III dhe V të aktgjykimit. Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike në lidhje me pjesën I, III dhe V të aktgjykimit.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit dhe vendosi që fëmijë i mitur të besohet për kujdes dhe edukim paditësit.

Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i ankimuar përkitazi me kohëzgjatjen e kontakteve personale me fëmijun e mitur përmban shkelje esenciale të procedurës kontestimore dhe se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë. Gjykata Supreme ka vendosur se duhet dhënë prioritet interesit të fëmijut me qëllim të zhvillimit adekuat fizik dhe psikologjik të fëmijut dhe edukimit të tij/saj (neni 116 të LMMF). Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit dhe të paditurit është pjesërisht e bazuar.

Ac.nr.13/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, në çështjen juridike të paditësit V. A., nga Prishtina, të cilën e përfaqësonë Ndue Thaçi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës L. A., nga Prishtina, për zgjidhjen e martesës, përkitazi me ankesën e paditësit dhe atë të së paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr. 230/2004 datë 16.12.2004, në seancën e mbajtur më 30.03.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit dhe vërtetohet, në pjesën II edhe III të dispozitivit, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr. 230/2004 datë 16.12.2004.

Refuzohet si e pabazuar ankesa e së paditurës dhe vërtetohet, në pjesën III dhe IV të dispozitivit, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr. 230/2004 datë 16.12.2004.

Pranohet ankesa e paditësit dhe të paditurës dhe prishet në pjesën V të dispozitivit aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr. 230/2004 datë 16.12.2004, kurse lënda kthehet të njejtës Gjykatë për rigjykim.

I njejtë aktgjykim, në pjesën I dhe VI të dispozitivit, mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit C.nr. 230/2004 datë 16.12.2004, është zgjidhur martesa e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës. Në pjesën II të dispozitivit fëmijë i mitur K. A., e lindur më 11.07.2001, është besuar për ruajtje dhe edukim të paditurës-nënës. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar paditësi që në emër të detyrimit ushqimor t'ia paguajë fëmijës së mitur nga 100 € në muaj duke filluar nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi e gjersa të ekzistojnë kushtet e parapara ligjore. Me pjesën IV të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesa e së paditurës për detyrimin ushqimor përtej pjesës së gjykuar. Me pjesën V të dispozitivit është detyruar e paditura që të mundësojë paditësit të ketë kontakte me fëmijun e tyre të mitur tri herë në muajt të premten e parë, të dytë dhe të katërt të muajit, ashtu që paditësi do të marrë të mituren K. nga kopshti në ora 16,00 e do ta kthejë në kopsht të hënën në mëngjes në ora 8,00, ditën e dytë të festave fetare, shtetërore dhe ditën e dytë të ditëlindjes së fëmijut nëpërmjet kopshtit. Me pjesën VI të dispozitivit e paditura do të mban mbiemrin e vajzërisë H. dhe në pjesën VII të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë kanë paraqitur ankesa:

-paditësi për shkak të shkeljes thelbësore të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së dejtës materiale me propozim që aktgjykimi i goditur, në pjesën I, III dhe V të dispozitivit ta ndryshojë ashtu që paditësit t'i besohet në ruajtje dhe edukim e mitura K. A., prej ditës së hënë në orën 8,00 deri të premten në ora 16,00 ndërsa në ditët e vikendit, festave dhe pushimeve tjera të qëndrojnë te e paditura, ose të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim;

-e paditura për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i

goditur, në pjesën III dhe V të dispozitivit, të ndryshohet ashtu që paditësi të detyrohet të paguajë në emër të ushqimisë shumë prej 150 € në muaj.

Pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se ankesa e paditësit dhe ajo e së paditurës në pjesën V të dispozitivit janë të bazuara.

Nga shkresat e lëndës del se bashkëshortët kanë lidhur martesë më 29.06.2001, në Prishtinë. Në bashkësinë martesore kanë një fëmijë K., e lindur më 11.08.2001. Marrëdhëniet bashkëshortore në fillim kanë qenë të mira, por ato më vonë janë çrregulluar në mënyrë serioze. Për shkak të këtyre çrregullimeve të raporteve bashkëshortore, bashkësia martesore mes tyre ka pushuar më 3.04.2004 dhe ata jetojnë të ndarë: e paditura me vajzën e tyre në shtëpinë e prindërve të saj, ndërsa paditësi jeton në shtëpinë e prindërve të tij.

Për shkak se marrëdhëniet martesore janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme, Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 67 të Ligjit për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (LMMF) që të zgjidhet martesa e ndërgjyqësve.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se Gjykata e Shkallës së Parë drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në bazë të saj e ka zbatuar drejt të drejtën materiale kur të mituren K. ia ka besuar për ruajtje dhe edukim s'ëmës, duke pasur parasysh mendimin e Qendrës për Punë Sociale Prishtinë, moshën e fëmijës.

Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, të pabaza janë thëniet në ankesën e të paditësit se me aktgjykimin e goditur gabimisht janë zbatuar dispozitat materiale me rastin e besimit e të miturës s'ëmës së saj. Duke pasur parasysh moshën e fëmijës dhe faktin se nëna-e paditura, është e arsimuar, e ka të siguruar çështjen e banimit dhe është në gjendje që shumë më tepër të kontribuojë në ngritjen dhe edukimin e saj, është në interesin e fëmijës t'i besohet të paditurës. Përveq kësaj, Gjykata e Shkallës së Parë ka vërtetuar drejt në bazë të provave, se e mitura emocionalisht është e lidhur me nënën, se nëna me së miri mund të kujdeset për të. Gjykata e Shkallës së Parë, me vlerësimin e provave të nevojshme ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, në bazë të së cilës kanë zbatuar drejt të drejtën materiale përkatësisht nenin 116 të LMMF, me të cilin parashikohet se Gjykata, e cila merr vendimin mbi besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim, në mes tjerash, posaçërisht i merr parasysh nevojat emocionale dhe dëshirat e fëmijës.

Në arsyetimin e aktgjykimin Gjykata e Shkallës së Parë ka dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare për marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të

procedurës kontestimore, të parsahikuara nga neni 354 par. 2 të LPK, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, Gjykata e Shkallës së Parë drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në bazë të gjendjes së këtyre dhe ka zbatuar drejt të drejtën materiale përkatësisht me pjesën II të dispozitivit, që ka të bëjë me detyrimin e paditësit që të kontribuojë për ushqimin e së miturës si dhe me lartësinë e saj në emër të ushqimit, duke dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Janë me bazë thëniet e ankesës të paditësit dhe së paditurës se aktgjykimi është marrë me shkelje thelbësore të dispozitës të procedurës kontestimore, të parashikuara nga neni 354 par. 2 pika 14 të LPK, ngase ai nuk përmban arsye për faktet vendimtare lidhur me mënyrën dhe kohëzgjatjen e kontakteve personale të paditësit me fëmijun e mitur. Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk përmban asnjë arsye, përveq konstatimit në arsyetimin se kontakti i fëmijës së mitur me paditësin do të bëhet tri herë në muaj dhe atë çdo të premte të parë, të dytë dhe të katërtën e muajit, dhe se paditësi do të marrë të mituren nga kopshti në ora 16,00 dhe do ta kthejë në kopsht të hënën në mëngjes në ora 8,00, ditën e dytë të fesatave fetare, shtetërore dhe ditën e dytë të ditëlindjes së fëmijut, përmes kopshtit. Se çfarë e ka motivuar Gjykatën e Shkallës së Parë për një vendim të tillë, aktgjykimi i goditur nuk përmban kurrfarë arsye lidhur me vendimin e saj, pra nuk ka arsye për faktin vendimtar-përparësinë e interesit të fëmijës për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e saj neni 116 të LMMF).

As gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht-cili është interesi më i madh i fëmijës të kontaktojë me paditësin-babën, dy herë në muaj dhe atë gjatë vikendit të dytë dhe të katërtë, siç ka propozuar Qendra për Punë Sociale në Prishtinë, apo kontaktimi të bëhet tri herë në muaj dhe atë çdo të premte të parë, të dytë dhe të katërtë të muajit, sikurse ka vendosur Gjykata e Shkallës së Parë.

Me nenin 111 par. 3 të LMMF parashikohet që gjykata do të rregullojë me aktgjykim edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindërin, i cili nuk e ushtron të drejtën prindërore, nëse prindi tjetër e pengon në këtë gjë, ose, nëse, duke i çmuar të gjitha rrethanat e rastit, konstaton se kjo gjë është e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës.

Duke qenë se aktgjykimi është prishur në pjesën V të dispozitivit, u prishë edhe në pjesën VII të dispozitivit që ka të bëjë me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë në pjesën I dhe VI të dispozitivit, mbetet i pashqyrtuar pasi që në këto pjesë nuk është goditur me ankesë.

Gjykata e Shkallës së Parë është e detyruar që në rigjykim të menjanojë të metat e cekura, gjegjësisht të veprojë sipas nenit 111 par. 3 të LMMF dhe, pasi t'i hetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejt psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës, të vendos për kohëzgjatjen e mbajtjes së kontakteve personale të paditësit me fëmijun e mitur, duke dhënë në aktgjykimin arsyet për të gjitha faktet vendimtare dhe duke i pasur parasysh edhe thëniet ankimore të paditësit dhe të paditurës, dhe mandej të marrë një vendim të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e me zbatimin e neneve 368 dhe 370 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.13/2005, datë 30.03.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa pranohet pjesërisht - Neni 67 LMMF - besimi i fëmijës - kontaktet personale me fëmijën e mitur - Neni 116 LMMF/ Nenet 111 (3) LMMF/ Nenet 368 dhe 373 LPK]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit dhe vendosi që fëmiju i mitur të besohet për kujdes dhe edukim paditësit.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me kohëzgjatjen e kontakteve personale me fëmijun e mitur ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale. Gjykata Supreme ka vendosur se arsyetimi mund të kufizohet vetëm për qëllime të mbrojtjes së shëndetit dhe interesave tjerë përkatës të fëmijut siç parashikohet me nenin 111 paragrafin 3 të LMMF. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e palës së paditur është pjesërisht e bazuar.

Ac.nr.16/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS kolegjii i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Mr.Rifat Zylfiu dhe Shahdane Agani, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses A. S. nga Skenderaj, të cilën e përfaqëson Ramadan Berisha, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit N. S. nga Prishtina, për zgjidhjen e martesës, përkritazi me ankesën e të paditurit paraqitur kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr.262/2004 datë 11.01.2005, në seancën e mbajtur me 28.04.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe vërtetohet në pjesën II të dispozitivit aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr.262/2004 datë 11.01.2005.

Pranohet ankesa e të paditurit dhe aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë ndryshohet në pjesën III të dispozitivit, që ka të bëjë me kontaktin personal të të paditurit me të miturën G., ashtu që caktohet kontakti personal dy herë në muaj - çdo të premte të parë dhe të tretë të muajit, kur paditësja do ta dorëzojë fëmijën e mitur prej orës 15:00 të premtën-babait në lokale të Qendrës për Punë Sociale në Skenderaj dhe i padituri do t'ia kthejë paditëses të dielën në

orën 15:00, para shtëpisë së saj, ndërsa lidhur me festat fetare, festat shtetërore dhe ditën e dytë të ditëlindjes së fëmijës, aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, në pjesën I, IV dhe V të dispozitivit, mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr.262/2004 datë 11.01.2005, është zgjidhur martesë e lidhur me 20.03.1999 në Prishtinë mes paditëses dhe të paditurit. Me pjesën II të dispozitivit, e mitura G., e lindur më 19.04.1999, i është besuar për ruajtje dhe edukim nënës - paditëses, pa detyrimin e të paditurit (tani për tani) për pagimin e ushqimit. Me pjesën III të dispozitivit, është vendosur që kontakti personal i së miturës G. me babanë e saj të bëhet dy herë në muaj - të premten e parë dhe të tretë të muajit, prej orës 12-14, ditën e dytë të festave fetare, shtetërore dhe ditën e dytë të ditëlindjes së fëmijës, përmes Qendrës për Punë Sociale në Skenderaj. Me pjesën IV të dispozitivit, është vendosur që paditësja ta mbajë mbiemrin e vajzërisë B.. Me pjesën V të dispozitivit, është detyruar i padituri që asaj t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 40 €, në afat prej 15 ditësh.

Kundër këtij aktgjykimi, ndaj pjesës II dhe III të dispozitivit, i padituri me kohë ka paraqitur ankesë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi, në pjesën e goditur, të ndryshohet ashtu, që fëmija i mitur t'i besohet të paditurit për ruajtje dhe edukim.

Paditësja ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës me propozimin që ankesa e të paditurit të refuzohet si e pabazuar.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit në pjesët e goditura sipas nenit 365 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se ankesa e të paditurit, që ka të bëjë me pjesën II të dispozitivit, është e pabazuar, ndërsa në pjesën III të dispozitivit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se bashkëshortët kanë lidhur martesë më 20.03.1999. Në këtë bashkësi martesore u ka lindur e mitura G.. Në fillim, marrëdhëniet martesore të tyre kanë qenë të mira, por ato më vonë janë çrregulluar për shkak të karaktereve të ndryshme, ashtu që jeta e përbashkët e bashkëshortëve është bërë e pamundur. Bashkëshortët jetojnë ndaras dhe bashkësia mes tyre definitivisht ka pushuar që nga maji i vitit 2004, kurse e mitura prej ndarjes faktike të bashkësisë martesore gjendet te paditësja.

Për shkak se marrëdhëniet martesore janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme, duke pasur parasysh faktin se në vitin 2004 jeta bashkëshortore mes tyre faktikisht është ndërprerë, Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 67 të LMMF që të zgjidhet martesë e ndërgjyqësve. E mitura i është besuar për ruajtje dhe edukim nënës - paditëses, duke pasur parasysh edhe propozimin e Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se Gjykata e Shkallës së Parë e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, në bazë të së cilës e ka zbatuar drejt edhe të drejtën materiale me zgjidhjen e martesës së ndërgjyqësve dhe me besimin e fëmijës së mitur, duke dhënë në arsyetimin e aktgjykimit arsye të mjaftueshme, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, vendimi për besimin e së miturës Gresa është i drejtë, duke pasur parasysh mendimin e Qendrës për Punë Sociale Prishtinë dhe moshën e së miturës, së cilës i nevojitet kujdesi i nënës. Kjo edhe për arsye se e mitura, prej ndarjes faktike të bashkësisë martesore, gjendet tek paditësja dhe lidhjen emocionale me nënën. Përveç kësaj, baza ekonomike është kusht me rëndësi për besimin e fëmijëve të mitur për ruajtje dhe edukim, por nuk është i vetëm dhe vendimtar, prandaj nuk mund të thuhet se është në interesin e fëmijës së mitur që ajo, vetëm për atë shkak, t'i besohet të paditurit - babait, duke pasur parasysh faktin që edhe paditësja ka kushte të mira ekonomike dhe banesore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, në pjesën III të dispozitivit, që ka të bëjë me kontaktin personal të të paditurit me të miturën, duhet ndryshuar, duke i çmuar të bazuara thëniet në ankesën e të paditurit që kanë të bëjnë me kontaktin personal, për arsye se Gjykata e Shkallës së Parë në këtë pjesë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale me caktimin e kontakteve personale dy herë në muaj - prej orës 12-14 në Qendrës për Punë Sociale në Skenderaj.

Me dispozitën e nenit 111 par.3 të LMMF, është parashikuar që Gjykata do ta rregullojë me aktgjykim edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin i cili nuk e ushtron të drejtën prindërore, nëse prindi tjetër e pengon në këtë gjë, ose, nëse, duke i çmuar të gjitha rrethanat e rastit, konstaton se kjo gjë është e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës. Duke u nisur nga dispozita e lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit që kontakti personal i të paditurit me fëmijën e mitur të caktohet dy herë në muaj - në vikendin e parë dhe të tretë, si kohë e mjaftueshme duke i dhënë përparsi interesit të fëmijës së mitur për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e saj. Paditësja çdo të premte të parë dhe të tretë, prej orës 15:00 do ta dorëzojë fëmijën e mitur të paditurit- babait në Qendrën për Punë Sociale në Skenderaj, ndërsa do ta marrë të miturën G. nga i padituri të

dielen në orën 15,00 para shtëpisë së saj, meqë të dieleve Qendra për Punë Sociale nuk punon. Kjo për arsye se caktimi i kontaktit personal dy herë në muaj nga dy orë, siq ka vepruar Gjykata e Shkallës së Parë është kundër interesave të së miturës me prindin të cilit ajo nuk i është besuar. Kontaktet mund të kufizohen vetëm për arsye të mbrojtjes së shëndetit dhe të interesave të tjera të rëndësishme të fëmijës dhe për këto arsye aktgjykimi në këtë pjesë të dispozitivit u ndryshua.

Aktgjykimi i shkallës së parë, në pjesën I, IV dhe V të dispozitivit, mbetet i pashqyrtuar, pasi në këto pjesë nuk është goditur me ankesë.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 368 lidhur me nenin 373 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.16/2005, datë 28.04.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa pranohet - Neni 67 LMMF - besimi i fëmijëve të mitur - Neni 354 (2) pika 14 LPK]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit dhe vendosi që fëmiu i mitur të besohet për kujdes dhe edukim paditësit.

Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i kundërshtuar përkitazi me vendimin për besimin e fëmiut për kujdes dhe edukim përmban shkelje esenciale të procedurës kontestimore dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të plotë. Gjykata Supreme ka vendosur se baza financiare është kusht i rëndësishëm për besimin e fëmiut të mitur për kujdes dhe edukim mirëpo nuk është fakti i vetëm vendimtar. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e palës së paditur është pjesërisht e bazuar.

Ac.nr.17/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, në çështjen juridike të paditëses F. B., nga fshati Beleg, komuna e Deçanit, kundër të paditurit B. B., nga fshati Beleg, komuna e Deçanit, për zgjidhjen e martesës, përkitazi me ankesën e paditëses, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 332/2004 datë 13.01.2005, në seancën e mbajtur më 30.03.2005, mori këtë

A K T V E N D I M

Pranohet ankesa e paditëses dhe priset në pjesën II dhe III të dispozitivit aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 332/2004 datë 13.01.2005, kurse lënda i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

I njejtë aktgjykim, në pjesën I të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 332/2004 datë 13.01.2005, është zgjidhur martesa ndërmjet paditëses dhe të paditurit, e lidhur më 5 maj 1997 në Zyrën e Vendit në Deçan. Me pjesën II të dispozitivit fëmijët e mitur Sh. B., i lindur më 29.10.1999, Sh. B., i lindur më

24.04.1998 dhe Sh. B., e lindur më 15.05.1997, janë besuar për ruajtje dhe edukim të paditurit-babas. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar i paditurit që t'i mundësojë paditëses të ketë kontakte me fëmijët e tyre të mitur të premtën e parë dhe të fundit në muaj, në Qendrën për Punë Sociale në Deçan, prej orës 12:00 e gjer në ora 14:00. Me pjesën IV të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja me kohë ka paraqitur ankesë me propozimin që aktgjykimi në pjesën III të dispozitivit të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, ka gjetur se ankesa, në pjesën II të dispozitivit të aktgjykimit të goditur është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se ndërgjyqësit kanë lidhur bashkësinë martesore më 5.05.1997 në Zyrën e Vëndit në Deçan. Në këtë bashkësi martesore u kanë lindur tre fëmijë. Në fillim të martesës marrëdhëniet martesore kanë qenë të mira, por më vonë ato janë çrregulluar në mënyrë serioze. Për shkak të këtyre çrregullimeve të raporteve bashkëshortore, bashkësi martesore e tyre ka pushuar në muajin qershor të vitit 2004 dhe ata jetojnë ndaras-paditësi me fëmijët e tyre jeton në shtëpinë e tij në fshatin Beleg, ndërsa paditësja te prindërit e saj.

Për shkak se marrëdhëniet martesore janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme, Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet e pararpara me nenin 67 të Ligjit për Martesë dhe Marrëdhëniet Familjare (LMMF), që të zgjidhet martesë e ndërgjyqësve.

Gjykata e Shkallës së Parë fëmijët e mitur të ndërgjyqësve ia ka besuar për ruajtje dhe edukim të paditurit, si babë, duke pasur parasysh mendimin e Qendrës për Punë Sociale në Deçan se i padituri ka kushtet ekonomike shumë më të mira ndërsa kujdesi ndaj fëmijëve është në nivel.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i goditur për sa i përket vendimit për besimin dhe ruajtjen e fëmijëve, është marrë me shkëlqje thelbësore të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 354 par. 2 pika 14 të LPK. Përveq kësaj, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban arsye për faktet vendimtare, të rëndësishme për gjykimin e drejt të kësaj çështjeje-juridike dhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë. Në mendimin e Qendrës për Punë Sociale në Deçan përshkruhen kushtet materiale dhe banesore të ndërgjyqësve dhe theksohet se kushtet materiale të të paditurit janë më të mira se ato të paditëses, se fëmijët e mitur, pas pushimit faktik të bashkësisë martesore,

gjenden tek i padituri dhe se janë adaptuar në atë mjedis familjar.

Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka dhënë fare arsye për faktet që kanë të bëjnë me moshën e re të fëmijëve të mitur, të cilët jetojnë me të paditurin-babën dhe me njerkin, kur ka pushuar bashkësi martesore e ndërgjyqësve, lidhjen emocionale të fëmijëve me njërin apo tjetrin prindë, ndikimin e drejtpërdrejtë të prindërve në edukimin e tyre. Baza ekonomike është kusht me rëndësi për besimin e fëmijëve të mitur për ruajtje dhe edukim, por nuk është i vetëm dhe vendimtar, prandaj nuk mund të thuhet se është në interesin e fëmijëve të mitur të ndërgjyqësve që ata, vetëm për këtë shkak, t'i besohen të paditurit-babas.

Me dispozitën e nenit 116 të LMMF është parashikuar që Gjykata, përkatësisht organi i kujdestarisë, i cili merr vendimin për besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që t'i hetojë në mënyrë të përshtatshme të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës dhe, me rastin e marrjes së vendimit, të niset, në radhë të parë, nga interesat e tij.

Duke qenë se aktgjykimi është prishur në pjesën II të dispozitivit, u prishë edhe në pjesën III të dispozitivit që ka të bëjë me caktimin e kontaktit personal të nënës me fëmijët e mitur dhe në pjesën IV të dispozitivit që ka të bëjë me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore.

Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, në pjesën I të dispozitivit, mbetet i pashqyrtuar, pasi që në këtë pjesë, nuk është goditur me ankesë.

Gjykata e Shkallës së Parë është e detyruar që në riprocedurë t'i menjanojë të metat e cekura, duke i pasur parasysh edhe thëniet ankimore të paditëses, të marr mendimin e ekspertit përkatës lidhur me ndikimin që mund të ketë ndërrimi i mjedisit jetësor në psikikën e fëmijëve të mitur, pastaj të kërkojë nga ana e kujdestarisë të jap mendim dhe propozim të prerë se cilit prej prindërve duhet t'u besohen fëmijët e mitur dhe t'i hetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi, gjithmonë duke u nisur nga interesi i fëmijëve. Me atë rast posaçërisht merren parasysh nevojat emocionale të fëmijëve, çka do të thotë se interesat e prindërve vijnë në rend të dytë.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e me zbatimin e nenit 369 dhe 370 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.17/2005, datë 30.03.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa refuzohet - Neni 365 LPK/ Neni 67 LMMF/ Neni 354 (2) LPK - kompetenca gjykatës - neni 62/65 Ligji për zgjidhjen e Konflikteve të ligjeve të Shteteve të tjera RSFJ 42/82]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka gjetur se kërkesat e parashikuara me nenin 67 të LMMF janë plotësuar për prishjen e martesës ndërmjet ndërgjyqësve. Gjykata Supreme ka vendosur se kërkesëpapia që ka të bëjë me jokompetencën e gjykatës nuk ishte gjetur për shkak se kërkesat e parashikuara me nenin 62 të Ligjit mbi Konfliktet me Jurisdikcionet e Huaja që parashikon jurisdikcionin ndërkombëtar të Gjykatave, nëse marrim parasysh se palët në procedurë kanë qenë kosovar, nuk janë plotësuar. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e palës së paditur është e pabazuar.

Ac.nr.18/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetar, Shahdane Agani dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, në çështjen juridike të paditësit A. S. nga fshati Osek Hile Komuna e Gjakovës, tani me vendqëndrim të përkohshëm në RF të Gjermanisë, të cilin e përfaqëson Hasan Pruthi avokat nga Gjakova, kundër të paditurës A. S. e lindur M. nga Gjakova, tani me vendqëndrim të përkohshëm në RF të Gjermanisë, të cilën e përfaqëson Avdi Rizvanolli avokat nga Gjakova, për zgjidhjen e martesës përkitazi me ankesën e së paditurës paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë C.nr.438/2004 datë 17.2.2005, në seancën e mbajtur më 30.03.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e së paditurës dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë C.nr.438/2004 datë 17.2.2005.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Pejë C.nr.438/2004 datë 17.2.2005, është zgjidhur martesë mes paditësit dhe së paditurës, e lidhur më 28.4.2003 në Zyrën e vendit Skivjan Komuna e Gjakovës. Është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura me kohë ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, Gjykata Supreme ka gjetur se ankesa e së paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë më 28.4.2003 në Zyrën e vendit në Skivjan. Pas rregullimit të dokumentacionit nga ana e paditësit, më 31.1.2004, e paditura ka shkuar në Gjermani. Mirëpo menjëherë pas bashkimit të bashkëshortëve marrdhëniet mes tyre janë çrregulluar dhe për shkak të këtyre çrregullimeve bashkësia martesore faktikisht është ndërprerë në korrik të vitit 2004, ashtu që e paditura jeton te tezja në Gjermani. Ndërgjyqësit në këtë martesë nuk kanë pasur fëmijë.

Për shkak se raportet mes ndërgjyqësve janë çrregulluar dhe bashkësia martesore ka zgjatur gjashtë muaj, kur ajo faktikisht është ndërprerë në korrik të njëjtit vit, Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet e parashikuara me nenin 67 të LMMF, që të zgjidhet martesë e tyre.

Gjykata Supreme e Kosovës çmon se Gjykata e Shkallës së Parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, në bazë të së cilës e ka zbatuar drejtë edhe të drejtën materiale, duke zgjidhur martesën e ndërgjyqësve, për çka në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Martesë duhet të mbahet vetëm kur ekzistonë dashuria e ndërsjellë e bashkëshortëve, e cila shfaqet edhe me një bashkëjetesë të harmonishme të tyre dhe nuk mjafton për ruajtjen e saj vetëm dëshira e njërit bashkëshortë, sikurse pa bazë thuhet në ankesë, sipas së cilës është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Thëniet e së paditurës në ankesë për inkompetencën e Gjykatës në Kosovë për zgjidhjen e martesës janë të pabazuara, për arsye se sipas nenit 62 lidhur me nenin 65 të Ligjit për Zgjidhjen e Konflikteve të Ligjeve të Shteteve të Tjera, në raportet e caktuara me të cilat rregullohet kompetenca ndërkombëtare e Gjykatave në kontestet martesore parashikohet që nëse pala e

paditur pranon kompetencën e Gjykatës, por me kusht që palët në procedurë janë shtetasë të huaj ose paditësi e ka vendbanimin në RSFJ, ose nëse i padituri pranon kompetencën e Gjykatës në RSFJ. Në rastin konkret duke pasur parasysh që palët në procedurë janë Kosovare, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme nuk janë përmbushur kushtet e parapara me Ligjin e larëpërmendur (“Gazeta Zyrtare e RSFJ”, nr.43/82), i cili është i zbatueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24, për Ligjin në Fuqi në Kosovë të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Thëniet e të paditurës për fëmiun e adoptuar dhe për besimin e tij janë të pabazuara nga se e paditura nuk ka prezentuar Gjykatës kurfarë prove për adoptimin e fëmiut.

Aktgjykimi i goditur nuk përmbanë shkleje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të parashikuara nga neni 354 par.2 të LPK, të cilat kjo Gjykatë i vërenë edhe sipas detyrës zyrtare.

Thëniet tjera të ankesës janë një përsëritje e thënieve të cekura në seanca të mbajtura nga ana e të autorizuarit të së paditurës, të cilat kanë qenë objektë shqyrtimi me rastin e marrjes së vendimit nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.18/2005, datë 30.03.2004

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa refuzohet - Neni 273 LMMF - detyrimi ushqimor - Neni 296 LMMF/ Neni 273 (1) LMMF/ Neni 274 (1)LMMF]

Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Pejë urdhëroi paditësin të paguajë alimentacionin për të paditurin.

Gjykatë Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe në pajtim me nenin 273 paragrafin 1 dhe nenin 274 paragrafin 1 të LMMF-së. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.

Ac.nr.19/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, mr. Rifat Zylfiu dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit L. H., nga fshati Bardhaniq, komuna e Gjakovës, kundër të paditurës R. H., nga fshati Smaq, komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Ferid Gjickolli, avokat nga Peja, për shkak të ushqimisë, përkritazi me ankesën e paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 233/2003 datë 12.11.2004, në seancën e mbajtur më 27.04.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 233/2003 datë 12.11.2004.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 233/2003 datë 12.11.2004, është detyruar i padituri që në emër të ushqimisë t’ia paguaj paditëses 100 € në muaj duke filluar prej datës 13.12.2001 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore dhe atë prej 1 deri më datë 5 të muajit vijues për muajin paraprak ndërsa kistet e arritura për pagesë detyrohet të paguan në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së aktgjykimit si dhe detyrohet që në emër të

shpenzimeve të procedurës kontestimore t'i paguaj paditëses shumë prej 1.400 € të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi me kohë ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet dhe kërkesëpadija e të paditurës të refuzohet në tërësi si e pabazuar ose të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, ka gjetur se ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 212/2001 datë 13.12.2001, është zgjidhur martesja ndërmjet paditësit dhe të paditurës, e lidhur më 30.07.1999 dhe fëmiju i mitur, A., më 17.06.1992 i është besuar për ruajtje dhe edukim të paditurës; është detyruar paditësi që të paditurës dhe fëmijës së mitur, në emër të ushqimit, t'u paguajë për çdo muaj nga 200 DM, duke filluar prej datës 13.12.2001 e në të ardhmen, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për një pagesë të tillë.

Duke vendosur sipas ankesës së paditësit, Gjykata Supreme, me aktgjykimin Ac.nr. 9/2002 datë 27.11.2002, e ka prishur pjesën e aktgjykimit me të cilën është vendosur për detyrimin e paditësit për ushqimin e të paditurës dhe për fëmijën e mitur, dhe lënda iu ka kthyer Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim, me vërejtje se duhet të vërtetohen faktet vendimtare lidhur me mundësitë materiale të paditësit për pagesën e detyrimit ushqimor dhe për mundësitë materiale të së paditurës.

Gjykata e Shkallës së Parë, në rigjykim, pasi që ka bërë administrimin e provave nga faktet e pakontestueshme, ka gjetur se e paditura është e papunë - nuk evidencohet si e papunë në Qendrën për Punësim në Gjakovë, për shkak se nuk është punëtorë e kualifikuar, nuk ka gjasa të punësohet, ngase ka të kryer vetëm shkollën fillore, jeton në bashkësinë familjare me prindërit e saj të moshës 65 vjeçare, me një vëlla të papunësuar në "Metalik" në Gjakovë, i cili ka bashkëshortën dhe 5 fëmijë, ndërsa paditësi është student në Fakultetin e Edukimit në Gjakovë, jeton në bashkësi familjare me bashkëshorten e pakurorëzuar, me të cilën ka një fëmijë, me dy prindërit e tij dhe dy vëllëzërit, prej të cilëve një është i punësuar në RF të Gjermanisë ndërsa tjetri në Republikën e Sllovenisë dhe që të dy janë të martuar. Duke u nisur nga pohimet e vetë paditësit se është në gjendje të mirë financiare, ashtu që ka kushte optimale që të miturit A. t'i sigurojë kushte optimale për mbajtje dhe se të paditurës, po që se arrihet marrëveshja për zgjidhjen e martesës, do t'i sigurojë një banesë me qira në Gjakovë, Gjykata e Shkallës së Parë ka konkluduar se

paditësi, pa e rrezikuar ekzistencën e vet dhe të familjes së tij mund të kontribuojë për ushqimin e fëmijës së përbashkët të ndërgjyqësve dhe është në gjendje materiale t'i paguajë të paditurës dhe fëmijës së mitur ushqimin nga 100 € në muaj.

Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se Gjykata e Shkallës së Parë me administrimin e provave të nevojshme, drejt e në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në bazë të gjendjes së tij të vërtetuar, i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se paditësi është i detyruar që, në emër të ushqimit t'i paguajë të paditurës nga 100 € në muaj duke filluar prej 13.12.2001 e në të ardhmen deri sa ekzistojnë kushtet ligjore për këtë pagesë. Aktgjykimi i goditur, përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Shkallës së Parë, pas administrimit të provave ka gjetur se e paditura nuk siguron ekzistencën materiale që nga 17 gushti 2000, kur mes ndërgjyqësve ka pushuar bashkësia martesore, është e lindur më 1.01.1964, e ka të kryer shkollën fillore, është e papunësuar, nuk është shfrytëzuese e ndihmës sociale në Qendrën për Punë Sociale në Gjakovë. Paditësi ka punuar në botën e jashtme prej vitit 1992 deri në vitin 2000, kur është kthyer në shtëpinë e tij dhe mjetet e fituara i ka angazhuar në bashkësinë familjare të prindërve dhe vëllëzërve të tij me të cilët tani jeton, është i regjistruar si student, posedon pasuri të palutjshme dhe të luajtshme në fshatin Bardhaniq e cila pasuri nuk evidentohet në emrin e tij, prindërve apo vëllëzërve të tij.

Gjykata e Shkallës së Parë, duke i pasur parasysh rrethanat e mësipërme, ka konkluduar se paditësi është i detyruar të jap në emër të kontributit nga 100 € në muaj të paditurës për të jetuar. Duke marrë parasysh moshën e paditësit, ai mund të sigurojë shumë e gjykuar dhe ngase me këtë nuk cenohet ekzistenca e tij dhe fëmijëve të tij nga martesja e parë dhe nga marrëdhënia jashtëmartesore me gruan tjetër.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, që u përshkrua më sipër, e cila nuk vihet në dyshim përkundër faktit, se si arsyeja e goditjes së aktgjykimit në ankesë theksohet vërtetimi jo i plotë dhe i gabuar i gjendjes faktike, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, nuk qëndron jo vetëm kjo arsye e goditjes, por as arsyeja e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Kjo Gjykatë i pranon në tërësi si të drejta arsyet e Gjykatës së Shkallës së Parë për detyrimin e paditësit dhe për shumë e gjykuar që duhet të paguajë ai në emër të kontributit për ushqimin e të paditurës.

Vetëm fakti se paditësi mban një fëmijë nga martesja e parë dhe dy fëmijë nga marrëdhënia jashtëmartesore, sikurse theksohet në ankesë nuk do të

thotë se aktgjykimi nuk ka arsye për faktet vendimtare dhe që arsyet e dhëna të jenë kontradiktore me gjendjen e provave që janë nxjerrë, por nuk ka as shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, as zbatim të gabuar të së drejtës materiale, sepse arsyet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë janë të mjaftueshme, jo kontradiktore dhe në pajtim me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale. Në rastin konkret Gjykata e Shkallës së Parë ka marrë qëndrim se në këtë çështje juridike janë përmbushur kushtet e përcaktuara me dispozitën e nenit 273 të LMMF që të aprovohet kërkesa e së paditurës në emër të ushqimisë, për arsye se e njehta nuk e ka braktisur bashkëshortin e në anën tjetër paditësi ka pohuar se nuk ka pasur asnjë të keqe nga ana e bashkëshortës së vet dhe se ky pas kthimit nga Gjermania paditësen e ka gjetur me familjen e tij të cilën në fund të muajit prill të vitit 2000 e ka larguar nga shtëpia dhe e ka përcjell në familjen e saj. Ndërsa sipas nenit 296 par. 3 të LMMF, me rastin e çmuarjes së mundësive të personit që ka për detyrë të jap ushqimin, Gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha të ardhurat e tij dhe mundësitë reale për të realizuar fitimin, si dhe nevojat e tij vetjake dhe detyrimet ligjore të ushqimit. Këto dispozita ligjore, duke pasur parasysh moshën e paditësit, mundësitë reale që të fitojë me kryerjen e punëve në profesionin e vet ose në ndonjë profesion tjetër, nuk e përjashton detyrimin e tij për ushqimin e të paditurës. As fakti se paditësi ka detyrimin ligjor për ushqimin e fëmijut nga bashkësia martesore dhe dy fëmijëve nga bashkësia jashtëmartesore, nuk e përjashton detyrimin ushqimor, i cili nga Gjykata e Shkallës së Parë është caktuar drejt.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se Gjykata e Shkallës së Parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në bazë të një gjendjeje të tillë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale. Kur ka detyruar paditësin që të kontribuojë për ushqimin e të paditurës si dhe në lartësinë e saj në emër të ushqimit të së paditurës, duke dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Vendimi për detyrimin ushqimor ndaj të paditëses është marrë në pajtim me dispozitën e nenit 273 par. 1 dhe nenit 274 par. 1 të LMMF, në përpjestim me mundësitë materiale të paditësit. Shuma e caktuar mujore prej 100 € për të paditurën ia mundëson asaj një jetë normale në aspektin material, duke pasur parasysh standardin jetësor të popullatës në mjedisin në të cilin jeton ajo.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Ac.nr.19/2005, datë 27.04.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa refuzohet - Neni 365 LPK/ Neni 67 LMMF/ Neni 354 (2) LPK/ Neni 106 (2) LPK/ Neni 295 LPK/ Neni 10 LPK]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka gjetur se kërkesat e parashikuara me nenin 67 të LMMF janë plotësuar për prishjen e martesës ndërmjet ndërgjyqësve. Gjykata Supreme ka vendosur se martesa duhet të mbahet vetëm nëse ekziston dashuri e ndërsjellë ndërmjet bashkëshortëve e cila shfaqet nëpërmjet të bashkëjetesës së harmonishme dhe vullneti i vetëm njërit prej bashkëshortëve për të mbajtur martesën nuk mjafton. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.

Ac.nr.23/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani - Zylfiu, anëtare, në çështjen juridike të paditësit N. B., nga Brekoci, komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson Osman Lajçi, avokat nga Peja, kundër të paditurës V. B., nga fshati Osek Pashë, komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova, për zgjidhjen e martesës, përkritazi me ankesën e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 58/2005 datë 22.03.2005, në seancën e mbajtur më 26.05.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 58/2005 datë 22.03.2005.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, C.nr. 58/2005

datë 22.03.2005, është zgjidhur martesë e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës më 30.11.2001, në zyrën e vendit Brekoc. Me pjesën II të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura me kohë ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në ankesë me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se palët ndërgjyqësve kanë lidhur martesë më 30.11.2001 në zyrën e vendit në Brekoc. Në bashkësinë martesore nuk kanë pasur fëmijë. Deri në muajin mars të vitit 2003 marrëdhëniet bashkëshortore kanë qenë të mira, por prej kësaj date për shkak të çrregullimeve serioze dhe të vazhdueshme të marrëdhënieve bashkëshortore ata jetojnë ndaras.

Për shkak se marrëdhëniet martesore janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme, Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 67 të Ligjit për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (LMMF) që të zgjidhet martesë e ndërgjyqësve. Kjo ngase me ankesë nuk vihet në dyshim gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, të cilën kjo Gjykatë e pranon në tërësi, prandaj thënie të ankimore se Gjykata e Shkallës së Parë aktgjykimin e ka marrë në bazë të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata Supreme e Kosovës e ka refuzuar si të pabazuar.

Edhe sipas mendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, marrëdhëniet bashkëshortore mes ndërgjyqësve janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme, prandaj nuk ka gjasa për rivendosjen e tyre, veçanërisht duke e pasur parasysh kohën e kaluar nga ndërprerja faktike e jetës së përbashkët të bashkëshortëve. Duke i pranuar si të drejta arsyet e aktgjykimit të shkallës së parë, kjo Gjykatë vlerëson se janë të pabazuara edhe thëniet e ankesës se Gjykata e Shkallës së Parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga neni 354 par. 2 të LPK, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë thëniet e ankesës, të cilat në të paraqesin përsëritje të

thënieve nga përgjigja ndaj padisë, se është i gabuar përfundimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, se marrëdhëniet bashkëshortore nuk janë keqësuar në atë masë sa që jeta e përbashkët martesore e palëve të jetë bërë e pamundur. Ndërprerja e bashkësisë familjare ka ndodhur për shkak të mosmarrëveshjeve të ndërgjyqësve dhe ata jetojnë ndaras, gjë që tregon çart se marrëdhëniet martesore të ndërgjyqësve janë çrregulluar seriozisht, saqë qëllimi i martesës nuk mund të arrihet me moszgjidhjen e saj.

Gjykata e Shkallës së Parë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale-neni 67 i LMMF, kur e ka zgjidhur martesën, duke gjetur se martesë e ndërgjyqësve e ka humbur qëllimin e ekzistimit. Martesë duhet të mbahet vetëm kur ekziston dashuria e ndërsjellë e bashkëshortëve, e cila manifestohet edhe me bashkëjetesë të harmonishme të tyre dhe nuk mjafton për ruajtjen e saj vetëm dëshira e njërit bashkëshort, pra në ankesë pretendohet pa bazë se gabimisht është zbatuar e drejta materiale.

Nga parashtrësja e të autorizuarit të paditurës të datës 22.03.2005 del se i autorizuarit i të paditurës Gjykatën e ka njoftuar se është i penguar që të asistojë në seancën e caktuar për datën 22.03.2005, meqë më parë ka të caktuar shqyrtimin në Gjykatën Komunale Prizren. Nga kjo rezultoi se me parashtrësën e lartpërmendur nuk është thënë në mënyrë decisive se çka kërkohet me këtë parashtrësë, por vetëm njoftohet Gjykata e Shkallës së Parë që i autorizuarit i të paditurës është i penguar që të prezantojë në seancën për shqyrtimin kryesor të caktuar për datën e lartpërmendur.

Me nenin 106 par. 2 të LPK, parashikohet se parashtrësja duhet të jenë të kuptueshme dhe të përbëjnë çdo gjë që nevojitet për të vepruar sipas tyre.

Me nenin 295 të LPK, parashikohet se në qoftë se nga seanca e parë për në seancën kryesore ka munguar paditësi, apo në qoftë se në këtë seancë nuk vjen i padituri dhe nuk ekzistojnë kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës, si dhe kur në ndonjë seancë të mëvonshme mungon paditësi ose i padituri, shqyrtimi mund të mbahet.

Me nenin 10 të LPK, parashikohet se gjykata ka për detyrë të përpiket që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime që të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të drejtash që u takojnë palëve në procedurë.

Në rastin konkret autorizuarit i palës së paditur gjatë procedurës nuk u është përgjigjur thirrjeve për seancë, kurse në ankesë i referohet shkeljes së rregullave të procedurës në dëm të saj, qartazi keqpërdor vetë të drejtat që i përkasin sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe zvarrit procedurën me qëllim të shmangies së obligimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka

gjetur se janë të pabazuara thëniet e ankesës se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitës së procedurës kontestimore nga neni 354 par. 2 pika 8 e LPK.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Ac.nr.23/2005, datë 26.05.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa refuzohet - Neni 365 LPK/ Neni 67 LMMF/ Neni 354 (2) pika 8 LPK/ Neni 293 (2) LPK/ Neni 265 (2) LPK]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Prizren vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka gjetur se kërkesat e parashikuara me nenin 67 të LMMF janë plotësuar për prishjen e martesës ndërmjet ndërgjyqësve. Gjykata Supreme ka vendosur se martesa duhet të mbahet vetëm nëse ekziston dashuri e ndërsjellë ndërmjet bashkëshortëve e cila shfaqet nëpërmjet të bashkëjetesës së harmonishme dhe vullneti i vetëm njërit prej bashkëshortëve për të mbajtur martesën nuk mjafton. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit është e pabazuar.

Ac.nr.25/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Shahdane Agani dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses R. G. e lindur Gjesheviq nga Suhareka, të cilën e përfaqëson Mr.Durak Jasharaj avokat nga Prizreni, kundër të paditurit Sh. G. nga Suhareka, për zgjidhjen e martesës, përkitazi me ankesën e të paditurit paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut Prizren C.nr.484/2004 datë 18.03.2005, në seancën e mbajtur me 26.05.2005, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren C.nr.484/2004 datë 18.03.2005.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Prizren C.nr.484/2004 datë 18.03.2005, është zgjidhur martesë mes paditëses dhe të paditurit e lidhur më 05.06.1977, në Zyrën e Vendit në fshatin Mramor KK Prishtinë. Është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontetimore me propozimin që aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë më 05.06.1977. Bashkësia martesore mes bashkëshortëve faktikisht është ndërprerë në vitin 1999. I biri F. i lindur më 05.07.1987 prej ndarjes faktike të bashkësisë martesore jeton me paditësen i cili do të arrinë moshën madhore në korrik të këtij viti, prandaj Gjykata nuk ka vendosur lidhur me besimin e tij.

Gjykata e Shkallës së Parë seancën për shqyrtimin kryesor të datës 23.02.2005 ka mbajtur në mungesë të të paditurit dhe ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova që i padituri është thirur me rregullë. Në shkresat e lëndës gjindet fletëkthesa me nënshkrimin e të paditurit për ditën e mbajtjes së seancës më 23.02.2005. Të paditurit i është dërguar padia sipas nenit 293 par.2 të LPK dhe Gjykata në seancën kryesore ka vepruar sipas nenit 265 par.2 të LPK, për arsye se i padituri është njoftuar me ftesë të Gjykatës që ai do të dëgjohet në cilësinë e palës në procedurë, për të cilin faktë në shkresat e lëndës gjinden fletdërgesat.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike të vërtetuar dhe nga deklaratat e paditëses të marrë në pyetje në cilësinë e palës, Gjykata e Shkallës së Parë ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, duke zgjidhur martesën në bazë të nenit 67 të LMMF. Sipas mendimit edhe të kësaj Gjykate marrdhëniet bashkëshortore në mes të ndërgjyqësve janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe, nuk ka gjasa për rivendosjen e bashkësisë martesore, duke pasur parasysh edhe faktin që bashësia martesore në mes tyre është ndërprerë në vitin 1999.

Martesa duhet të mbahet vetëm kur ekzistonë dashuria e ndërsjellë e bashkëshortëve, e cila shfaqet edhe me një bashkëjetesë të harmonishme të tyre dhe nuk mjafton për ruajtjen e saj vetëm dëshira e njërit bashkëshort.

Thëniet në ankesën e të paditurit se aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 par.2 pika 8 të LPK, janë të pabazuara për arsye se në shkresat e lëndës gjindet fletdërgesat që i padituri është thirur me rregull.

Ftesat për shqyrtimin kryesor të datës 23.02.2005 janë dërguar në Stacionin Policor në Suharekë ku i padituri është punësuar si polic si dhe në adresën në Suharekë ku banon.

Në bazë të asaj që u tha me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.25/2005, datë 26.05.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Procedurën Kontestimore zgjidhje e martesës - ankesa refuzohet - Neni 365 LPK/ Neni 68 LMMF/ Neni 368 LPK]

I padituri paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke mbajtur qëndrimin se Gjykata ka zbatuar të drejtën materiale në mënyrë të gabuar dhe ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë vendosi për prishjen e martesës ndërmjet të paditurit dhe paditësit dhe vendosi që fëmijë i mitur të besohet për kujdes dhe edukim të paditurit.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale kur ka vendosur për formën dhe kohëzgjatjen e kontaktit me fëmijën e mitur. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e të paditurit është e pabazuar

Ac.nr.27/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, në çështjen juridike të propozuesve H. H., nga Ferizaji dhe A. A., nga Ferizaji, për zgjidhjen e martesës, përkitazi me ankesën e propozuesit, paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr. 128/2004 datë 10.11.2004, në seancën e mbajtur më 26.05.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e propozuesit dhe vërtetohet, në pjesën III të dispozitivit, aktgjyqimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr. 128/2004 datë 10.11.2004.

Aktgjyqimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, në pjesët I, II, IV dhe V të dispozitivit, mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, C.nr. 128/2004 datë 10.11.2004, është zgjidhur martesja e

propozuesve, e lidhur më 24.04.2002, zyrën e vendit në Ferizaj. Me pjesën II të dispozitivit, fëmija i mitur H. A., i lindur më 7.09.2002, i është besuar për ruajtje dhe edukim propozuesit-babës. Me pjesën III të dispozitivit, kontaktimi i propozueses me fëmijën e mitur është caktuar dy herë në muaj, gjatë ditëve të vikendit të parë dhe tretë, duke filluar prej ditës së premte, propozuesja do të marrë fëmijën në ora 15,00 në lokalet e Qendrës për Punë Sociale Ferizaj dhe do ta kthejë të hënën në ora 8,00 në Qendrën për Punë Sociale Ferizaj; ditën e dytë të festave fetare dhe shtetërore si dhe ditën e dytë të ditëlindjes së fëmijës, sipas orarit dhe vendit të lartpërmendur. Me pjesën IV të dispozitivit propozuesja tani e tutje do të mban mbiemrin e vajzërisë H. dhe me pjesën V të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktgjyqimi propozuesi me kohë ka paraqitur ankesë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktgjyqimi në pjesën III të dispozitivit të ndryshohet, ashtu që kërkesëpadia e propozuesës në këtë pjesë të aktgjyqimit të refuzohet si e pabazuar ose aktgjyqimi të priset dhe lënda t'i kthehet Gjykatës së Shkallës së Parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjyqimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, gjeti se ankesa e propozuesit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se propozuesit kanë lidhur bashkësinë martesore më 24.04.2002, në këtë bashkësi martesore u ka lindur një fëmijë H. më 7.09.2002. Në fillim të martesës marrëdhëniet martesore kanë qenë të mira, por më vonë ato janë çrregulluar në mënyrë serioze. Për shkak të këtyre çrregullimeve dhe raporteve bashkëshortore, bashkësia martesore e tyre ka pushuar dhe ata tani jetojnë ndaras.

Për shkak se marrëdhëniet martesore janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme, Gjykata e Shkallës së Parë sipas propozimit të propozuesve ka gjetur se janë plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 68 të Ligjit mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (LMMF), që martesja e ndërëgjyqësve të zgjidhet.

Thëniet në ankesën e propozuesit janë të pabazuara, kur thuhet se me aktgjykim nuk është vendosur drejt çështja e kontakteve të propozueses me fëmijën e mitur. Aktgjyqimi i shkallës së parë në këtë drejtim përmban arsytim të duhur se përse është vendosur që kontaktet e propozueses-nënës me fëmijën e mitur të bëhet në atë mënyrë që propozuesja ka për të marrë të miturin në lokalet e Qendrës për Punë Sociale Ferizaj në vikendin e parë dhe të tretë të muajit-të premten në orën 15:00 në lokalin e Qendrës për Punë Sociale Ferizaj dhe ka për ta kthyer të hënën në orën 8:00 në Qendrën për Punë Sociale Ferizaj, si kohë e mjaftueshme, duke i dhënë përparësi interesit të fëmijës të mitur për zhvillimin e drejt psikik dhe fizik dhe për edukimin e tij.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, Gjykata e Shkallës së Parë drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në bazë të gjendjes së këtyre e ka zbatuar drejt të drejtën materiale përkitazi me pjesën III të dispozitivit, që ka të bëjë në mënyrën dhe kohëzgjatjen e kontaktit të propozueses - nënës me fëmijën e mitur, duke dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën I, II, IV dhe V të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar, pasi që në këto pjesë ai nuk është goditur me ankesë.

Në bazë të asaj që u tha dhe me zbatimin e nenit 368 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Ac.nr.27/2005, datë 26.05.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

268 bosh